



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA  
KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
ZYRA E PRESIDENTES - KANCELARIJA  
PRESDENICE - OFFICE OF THE PRESIDENT

Nr / Br / No : 01/011-1052-02/23

Nr i fq / Br st / No. of pg :

Data / Datum / Date : 17 / 10 / 23

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Prishtinë, 17.10.2023

Për: Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës,

z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

## Njoftim

I nderuar z. Maloku,

Fillimisht, dëshiroj të shprehë përkushtimin tim të vazhdueshëm për bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës, gjithmonë brenda mandatit tim kushtetues si Presidente e Republikës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 84 i saj, ia atribuon Presidentes kompetencën dhe përgjegjësinë për ta garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë. Në këtë frymë buron edhe kompetenca që Kushtetuta ia përcakton Presidentes për të emëruar dhe shkarkuar Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Garantimi i funksionimit kushtetues të institucioneve nënkupton, mes tjerash, detyrimin e Presidentes për të ndërmarrë veprime, të cilat sigurojnë integritetin dhe rrisin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë sistemin prokurorial, ku pozitë qendrore ka Kryeprokurori i Shtetit. Funksionimi kushtetues i institucionit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit si dhe besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë lëkundet seriozisht kur ngriten mëdyshje lidhur me integritetin e procesit të zhvilluar në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Këto mëdyshje janë ngritur si nga ana e organizatave joqeveritare, ashtu edhe nga ana e partnerëve ndërkombëtarë.

Në këtë rrjedhë, sjell në vëmendjen tuaj se me datën 8 prill 2022, KPK-ja ka paraqitur propozimin për dekretimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.



Menjëherë pas kësaj, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës është informuar se disa nga kandidatët që i janë nënshtruar konkursit për Kryeprokuror të Shtetit, kanë ndjekur procedura gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese dhe në gjykatat e rregullta, duke kontestuar ligjshmërinë e procedurave të zhvilluara në KPK, dhe duke pretenduar se u janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.

Siç ju kam vënë në dijeni, gjatë komunikimeve tona të vazhdueshme ndërinstitucionale, si Presidente e Republikës së Kosovës jam përmbajtur nga ndërmarrja e veprimeve që do të mund të cilësoheshin si ndërhyrje apo paragjykim i procedurave gjyqësore që janë zhvilluar deri më tani lidhur me këtë çështje. Po ashtu, mosndërhyrja ime në këtë proces, bazohet edhe në faktin se Kryeprokurori i Shtetit është një prej posteve të themeluara me Kushtetutë që mund të ushtrohet edhe nga zëvendësit deri në emërimin e Prokurorit të ri të Shtetit, siç është sqaruar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 29/12 dhe KO 48/12.

Siç dihet tashmë, procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit është përcjellë me raportime e reagime për parregullsi të shumta, nga organizatat e pavarura që kanë monitoruar procesin e zhvilluar në KPK, duke përfshirë edhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët në vazhdimësi kanë mbështetur ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit prokurorial në vendin tonë.

Sikurse organizatat joqeveritare që e kanë monitoruar procesin, ashtu edhe mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë kanë shprehur shqetësime publike lidhur me integritetin e procesit të zhvilluar nga KPK-ja.

Këto shqetësime më janë paraqitur edhe mua nga një numër organizatash që kanë monitoruar procesin e zhvilluar në KPK për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. Ekziston një vlerësim i përgjithshëm i këtyre monitoruesve se procedura e zhvilluar në KPK është përcjellë me mosrespektim të disa kriterëve dhe parimeve themelore kushtetuese, respektimi rigoroz i të cilave është parakusht për garantimin e një propozimi të ligjshëm për Kryeprokuror të Shtetit, si dhe për rritjen e besimit të qytetarëve në instancën më të lartë të sistemit prokurorial. Këto vërejtje kanë të bëjnë me dështimin e vlerësimit të duhur të integritetit dhe profesionalizmit të kandidatëve e poashtu edhe me mosrespektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, meritokracisë dhe barazisë para ligjit.

Me keqardhje më duhet të theksoj se këto vërejtje e shkelje procedurale që janë konstatuar nga akterët ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe kontestimi i gjerë i tërë procesit nga ana e tyre, kanë qenë ndër arsyet kryesore për mua si Presidente që të përmbahem nga emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit. Kam shpresuar se të gjitha këto pretendime do shqyrtohen në meritë dhe në themel nga ndonjë instancë gjyqësore. Prandaj, siç edhe u kam vënë në dijeni shumë herë në të kaluarën, kam pritur që kjo çështje të trajtohet nga gjykatat tona. Megjithatë, asnjë nga gjykatat e rregullta, por as edhe vet Gjykata Kushtetuese, nuk e ka trajtuar procesin e përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror, duke e refuzuar proceduralisht trajtimin në themel të pretendimeve mbi procesin. Kjo pritje mori fund me



datën 11 tetor 2023, kur është publikuar Aktgjykimi i plotë lidhur në rastin nr. KI 90/23, me të cilin Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar aspektin procedural të ankesave dhe shterimit të mjeteve juridike të kandidatit të ankuar, pa hyrë fare në meritat e rastit, lidhur më procedurën e ndjekur nga KPK-ja për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror.

Në këto rrethana, kam qenë e detyruar t'i trajtoj shqetësimet se procedurat e ndjekura nga KPK-ja kanë dështuar t'i përmbushin standardet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore. Shkeljet dhe parregullsitë që karakterizuan procedurat e zhvilluara në KPK, rezultojnë me një proces që nuk ofron garanci për emërimin e një Kryeprokurori të Shtetit që gëzon reputacion profesional dhe integritet moral, si dhe minon besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës në sistemin e drejtësisë.

Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të dokumentacionit që KPK-ja, ia ka dorëzuar Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit dhe pas analizës së raporteve të monitoruesve të pavarur, vendorë e ndërkombëtarë, vlerësoj se procedurat e ndjekura nga KPK-ja, kanë dështuar t'i përmbushin standardet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore. Shkeljet dhe parregullsitë që karakterizuan procedurat e zhvilluara në KPK nuk ofrojnë garanci për emërimin e një Kryeprokurori të Shtetit që gëzon reputacion profesional dhe integritet moral, si dhe që rritë besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës në sistemin e drejtësisë. Këtë vlerësim e bëj, bazuar në kompetencat kushtetuese të Presidentes së Republikës të përcaktuara në Kushtetutë dhe të konfirmuara edhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese.

Prokuroritë dhe gjykatat janë mekanizmat kryesorë që sigurojnë sundim të ligjit dhe shtet të së drejtës, të cilat janë vlera themelore dhe aspirata sublime të shoqërisë dhe shtetit tonë. Ne, si krerë institucional, kemi mandat kushtetues dhe detyrim ligjor e moral që ta rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Kjo bëhet, në radhë të parë, duke mos përligjur dhe legjitimuar emërimet në funksionet me të larta të sistemit të drejtësisë, që burojnë nga procedura të komprometuara, me integritet të kontestuar në kuptim kushtetues e ligjor.

Prandaj, ju njoftoj se, në rrjedhë të ushtrimit të mandatit tim për të siguruar funksionimin kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, nuk do ta emërojë kandidatin e propozuar nga KPK-ja për Kryeprokuror të Shtetit, sipas propozimit që më është paraqitur me datën 8 prill 2022.

Duke rikonfirmuar përkushtimin tim për bashkëpunim, brenda frymës dhe normës kushtetuese, ftoj KPK-në që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i sanuar shkeljet e konstatuara, duke zhvilluar procedurë për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, në përputhje me kriteret kushtetuese dhe ligjore. Pres nga KPK-ja që t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për ta garantuar një proces të ligjshëm, të drejtë dhe transparent të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, duke marrë në konsideratë rekomandimet e organizatave joqeveritare dhe partnerëve ndërkombëtarë.



Republika e Kosovës, sot, më shumë se asnjëherë tjetër, ka nevojë të dëshmojë përkushtimin e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për zbatimin e parimit të sundimit të ligjit, në tërë territorin e Kosovës. Kjo arrihet më së miri atëherë kur të gjithë angazhohemi dhe përkushtohemi që bartësit e institucioneve të jenë fillimisht të zgjedhur nëpërmjet procedurave kushtetuese dhe ligjore. Propozimet dhe emërimet që përmbushin standardet kushtetuese dhe ligjore, mes tjerash i hapin rrugë edhe ushtrimit të autoritetit të plotë në cilindo institucion, në përmbushjen e obligimeve dhe detyrimeve kushtetuese.

Shteti ynë qëndron mbi shtylla dhe parime të rëndësishme, të cilat nuk guxojmë t'i rrezikojmë në asnjë rrethanë dhe për interesa të askujt. Në mënyrë që të mbrohen këto shtylla e këto parime, është detyrim kushtetues i kreut të shtetit që të parandalojë emërimet përmes procedurave të paligjshme, të cilat do të binin në kundërshtim me parimet e barazisë, paanshmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Ju ftoj që si institucion kyç brenda sistemit të drejtësisë, që edhe ju si Këshill Prokurorial ta bëni të njëjtën gjë gjatë realizimit të detyrave tuaja kushtetuese.

Bashkëlidhur me këtë Njoftim, ju lutem gjeni Shtojcën me vlerësimin tim mbi procedurën e zhvilluar në KPK për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, ku janë paraqitur parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara.

Sinqerisht,



---

Vjosa Osmani Sadriu

Presidente e Republikës së Kosovës

# SHTOJCA

## Vlerësimi i procedurës së zhvilluar në Këshillin Prokurorial të Kosovës për propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit

### Hyrje

Siç u theksua edhe në Njoftim, procedura e zhvilluar në Këshillin Prokurorial të Kosovës për përzgjedhjen e kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit është karakterizuar me parregullsi dhe shkelje që minojnë integritetin e tërë procesit. Këto parregullsi dhe shkelje janë evidentuar nga analizimi që Presidenca i ka bërë dosjes së konkursit të paraqitur nga KPK, sikundër që janë konstatuar edhe nga instancat ankimore brenda vet KPK-së dhe nga organizata dhe institucione të pavarura që kanë monitoruar procedurat e zhvilluara në KPK.

Këto gjetje dhe konstatime paraqiten në mënyrë të shtjelluar në këtë Shtojcë. Paraprakisht, është paraqitur kronologjia e veprimeve që ka ndërmarrë Presidentja e Republikës së Kosovës, që nga momenti i paraqitjes së propozimit të KPK-së.

Për më tepër, vlerësimi i kësaj procedure, është bërë duke u bazuar në kompetencat kushtetuese të Presidentes, në respektimin e praktikës së Gjykatës Kushtetuese, si dhe duke respektuar parimin e ndarjes së pushtetit, ashtu siç e përcakton kushtetuta dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.<sup>1</sup>

### I. Kronologjia e veprimeve të Presidentes

Me datën 8 prill 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka paraqitur propozimin që Presidentja e Republikës së Kosovës, në bazë të kompetencave kushtetuese, ta bëjë dekretimin e kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit.

Nga kjo datë, brenda kompetencave dhe përgjegjësive kushtetuese, Presidentja është angazhuar në vazhdimësi dhe aktivisht në këtë proces – siç vërehet nga rrjedha e veprimeve të paraqitura në vijim. Kjo është bërë duke qenë në komunikim të drejtpërdrejtë me KPK-në, si dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur shqetësimeve të ngritura rreth këtij procesi dhe procedurave gjyqësore që janë zhvilluar në lidhje me të.

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84, par. 17; Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastet nr. K199/14 dhe K1100/14 (2014), si dhe dokumenti nr. ref. KK 109/15 i votuar njëzëri nga Gjykata Kushtetuese në përbërje të plotë në seancën e datës 17 prill 2015, lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet nr. K199/14 dhe K1100/14.



Në këtë rrjedhë, me datën 20 prill 2022, në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës është dorëzuar një raport nga organizata të shoqërisë civile që kanë monitoruar procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit të zhvilluar në KPK.

Me datën 20 prill 2022, Presidentja i ka adresuar KPK-së kërkesën për ta paraqitur në Presidencë, dokumentacionin shtesë lidhur me procesin e zhvilluar në KPK për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Me datën 21 prill 2022, Presidentja ka pranuar nga KPK-ja, disa dokumente dhe materiale për procedurat e zhvilluara në KPK për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Me datën 13 maj dhe datën 15 qershor 2022, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës (ZPRK) është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese për regjistrimin e kërkesave KI 57/22 përkatësisht KI 79/22, të parashtruara nga dy kundërkandidatë që kontestuan kushtetutshmërinë e propozimit të KPK për Kryeprokuror të Shtetit.

Me datën 26 qershor 2022, ZPRK-ja është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese lidhur me Aktvendimin për Papranueshmëri KI57/22 dhe 79/22, me të cilin dy kërkesat e sipërcekura të kundërkandidatëve janë shpallur të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në gjykatat e rregullta.

Me datën 28 qershor 2022, ZPRK-ja është njoftuar së njëri nga kandidatët ka paraqitur padi për inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Me datën 15 gusht 2022, Presidentja ka pranuar nga KPK-ja një kërkesë të përsëritur për dekretim të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit.

Me datën 4 tetor 2022, me ftesë të Presidentes, në ZPRK është zhvilluar një takim në mes të Presidentes me Kryesuesin e KPK-së dhe me Ushtresin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë takim Presidentja i ka informuar se do ta pres shterimin e të gjitha afateve kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së zhvilluar në KPK për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit të mund t'i adresojnë pretendimet e tyre në rrugë gjyqësore. Aq më tepër kur vet Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kundërkandidatët e pakënaqur duhet të shterojnë mjetet juridike në gjykatat e rregullta.

Me datën 10 tetor 2022, përmes një përgjigjeje me shkrim, Presidentja e ka njoftuar Kryesuesin e KPK-së, se është në pritje të përfundimit të procedurave gjyqësore lidhur me çështjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Me datën 27 dhjetor 2022, ZPRK-ja është informuar për Aktgjykimin Refuzues të Gjykatës Supreme, me të cilin janë shteruar të gjitha procedurat gjyqësore në gjykatat e rregullta për kontestimin e procedurave të zhvilluara në KPK. Në ndërkohë kanë filluar të rrjedhin afatet brenda të cilave kundërkandidatët kanë pasur të drejtë të referojnë vendimin e Gjykatës Supreme në Gjykatën Kushtetuese.



Me datën 5 prill 2023, Presidentja sërish ka pranuar kërkesë nga KPK-ja, përmes së cilës është kërkuar që Presidentja “urgjentisht”, ta dekretoj kandidatin e propozuar për Kryeprokuror të Shtetit.

Me datën 6 prill 2023, Presidentja i ka kthyer menjëherë përgjigje me shkrim KPK-së, duke përsëritur sqarimin për pritjen e shterimit të të gjitha afateve kushtetuese dhe ligjore që kundërkandidatët e pakënaqur kanë në dispozicion për t'i adresuar pretendimet e tyre për parregullsi dhe shkelje në procedurën e zhvilluar në KPK.

Me datën 7 prill 2023, Presidentja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për t'u informuar nëse pas shterimit të mjeteve të rregullta (Aktgjykimit të Gjykatës Supreme), Gjykata Kushtetuese ka pranuar ankesë individuale lidhur me çështjen e procedurave të zhvilluara për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

Me datën 14 prill 2023, Presidentja është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese se deri në atë ditë nuk kishte pranuar ndonjë ankesë individuale ndërlidhur me çështjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Me datën 4 maj 2023, Presidentja i është drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese, meqë Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ofron dy momente të rrjedhës së afatit lidhur më periudhën katër (4) mujore për paraqitjen e kërkesave në këtë Gjykatë – pra kërkesa individuale në Gjykatën Kushtetuese parashtrihen brenda afatit prej katër (4) muajve dhe afati fillon të rrjedhë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor, të cilin e konteston, ose në ditën kur vendimi ose akti i kontestuar është shpallur publikisht. Adresimi i sërishëm tek Gjykata Kushtetuese është bërë meqë Presidenca nuk mund të kishte informacion për kohën kur Aktgjykimi i mësipërm i Gjykatës Supreme i është dorëzuar palës, rrjedhimisht kur mund të përfundojë afati katër (4) mujor, bazuar në datën e pranimit të aktgjykimit nga pala.

Me datën 12 maj 2023, Presidentja është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese se njëri nga kundërkandidatët në procedurën për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Me datën 29 shtator 2023 Gjykata Kushtetuese ka njoftuar se ka vendosur lidhur më kërkesën në rastin Nr. KI 90/23, ndërsa më datë 11 tetor 2023, Gjykata ka publikuar Aktgjykimin e plotë lidhur me rastin Nr. KI 90/23, në të cilin Gjykata Kushtetuese, kishte vlerësuar aspektin procedural të ankesave dhe shterimit të mjeteve juridike të kandidatit të ankuar, pa hyrë në meritat e rastit, lidhur me procedurën e ndjekur nga KPK-ja për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror.

Në dritën e rrjedhës së mësipërme të veprimeve, angazhimi i vazhdueshëm i Presidentes në këtë proces ka qenë gjithmonë brenda mandatit dhe përgjegjësi kushtetuese, në shërbim të garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve, si dhe duke respektuar parimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, duke përfshirë si gjykatat ashtu edhe KPK-në. Gjatë gjithë kësaj periudhe, pozita e Kryeprokurorit është ushtruar nga ushtruesi i detyrës, i cili nuk ka asnjë kufizim të vetëm në ushtrimin e kompetencave.



## II. Vlerësimi i procedurave të ndjekura nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Procesi i përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga ana e KPK-së është përcjellë me defekte të shumta, të evidentuara si nga monitoruesit e pavarur të procedurave të zhvilluara në KPK, poashtu edhe nga kundërkandidatët konkurrues në këtë proces. Vërejtje dhe konstatime për shkeljet në procedurën e zhvilluar në KPK, janë bërë edhe nga vet organet e brendshme të KPK-së, gjegjësisht Komisioni për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve ndaj procesit të Emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit (Komisioni për Rishqyrtim), si dhe nga monitoruesit e pavarur vendorë e ndërkombëtarë. Për më tepër, këto vërejtje janë reflektuar edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Kosovën për vitin 2022 (të paraqitur më poshtë). Për fat të keq, këto pretendime për parregullsi kanë mbetur pa u adresuar në mënyrë meritore nga ndonjë instancë gjyqësore.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga KPK-ja dhe në dritën e vërejtjeve të shumta që janë ngritur nga monitoruesit e pavarur vendor dhe ndërkombëtar, Presidenca ka vlerësuar se ngriten dyshime të bazuara se ka shkelje të theksuara procedurale në procedurat e zhvilluara në KPK për përzgjedhjen e kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit.

Konsiderojmë se parimi i drejtësisë, integritetit e barazisë, me transparencë të lartë dhe llogaridhënie, nuk është vetëm obligim i gjykatave, por i të gjitha institucioneve publike që zhvillojnë procedura publike të rekrutimit, emërimit dhe propozimit të kandidatëve në pozita publike, për aq sa kanë kompetencë. Kriteri i shfaqjes apo paraqitjes publike dhe transparente të administrimit të drejtësisë, siç është përcaktuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut,<sup>2</sup> duhet të vlejë për të gjitha institucionet publike, përfshirë për KPK-në, siç është konfirmuar tashmë nga praktika e Gjykatës Kushtetuese.<sup>3</sup> Kjo për faktin se edhe KPK-ja si çdo organ tjetër në një proces të propozimit të kandidatit për kryeprokurorë, detyrë parësore e ka interpretimin e ligjeve dhe rregulloreve të brendshme përgjatë zbatimit të procedurave. Në këtë drejtim edhe vet kushtetuta jonë, kërkon që të drejtat dhe liritë themelore të interpretohen pikërisht mbi standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>4</sup> dhe ky obligim, nuk duhet assesi të shihet vetëm si obligim i gjykatave, por i të gjitha institucioneve të cilat janë të veshura me autoritetin për t'i interpretuar aktet normative në çfarëdo procesi, i cili ndërlidhet me liri dhe të drejta të njeriut, siç është edhe rasti konkret.

<sup>2</sup> *Micallef kundër Maltës*, GJEDNJ (2009).

<sup>3</sup> Detyrimi i KPK-së për të respektuar edhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe praktikën e GJEDNJ-së, krahas Kushtetutës së Kosovës, është potencuar edhe në Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pika 73, ndërsaq Komentari i Kushtetutës potencon në f. 201, par. 2, se përveç gjykatave, edhe organet e tjera e kanë për detyrë të respektojnë praktikën e GJEDNJ, ashtu siç përcakton neni 53 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53.



## **1. Moszbatimi i kriterit ligjor për vlerësimin e reputacionit profesional dhe integritetit të kandidatëve konkurrues për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit**

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në ndërlidhje me nenin 28 të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, një nga kriteret kryesore procedurale dhe ligjore për propozimin e kandidatit nga KPK-ja, për pozita drejtuese në sistemin prokurorial është vlerësimi i integritetit të kandidatëve. Përveç Ligjit për Prokurorin e Shtetit, kjo përcaktohet shprehimisht edhe në Rregulloren 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës. Neni 3, paragrafi 1.6 i Rregullores në fjalë përcakton se, *inter alia*, për të aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, aplikuesi duhet të ketë “*reputacion të lartë profesional dhe integritet moral.*”

Për t’u plotësuar ky kriter, vlerësohet se është e nevojshme që KPK-ja, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të bërë një vlerësim serioz dhe transparent të reputacionit profesional dhe integritetit moral të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit. Në rastin konkret, janë konstatuar shkelje serioze gjatë procedurës së zhvilluar në KPK, sepse nuk janë ndërmarrë hapa të nevojshëm procedural për të vlerësuar integritetin e kandidatëve, përfshirë këtu edhe kandidatin e propozuar për Kryeprokuror të Shtetit. Ky nuk është vetëm vlerësim i Presidencës, por edhe i vet Komisionit për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve të KPK-së, si dhe i monitoruesve të pavarur.

Ky vlerësim është bazuar edhe në gjetjet e shumta të organizatave joqeveritare që e kanë monitoruar procesin. E konsiderojmë të rëndësishme ta sqarojmë rëndësinë që ka përfshirja e organizatave joqeveritare në të tilla procese. Në opinionin e Komisionit të Venedikut lidhur me draftligjin për emërimet e larta të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, mes tjerash theksohet rëndësia që ka pjesëmarrja e anëtarëve të shoqërisë civile nëpërmjet mbikëqyrjes së procesit të zgjedhjes së personave me reputacion të lartë dhe të pranueshëm.<sup>5</sup>

Ndërlidhur me vlerësimet e organizatave monitoruese, fillimisht, sa i përket kriterit të profesionalizmit, sjellim në vëmendjen tuaj gjetjet e Raportit të OJQ-ve (Instituti i Kosovës për Drejtësi/Grupi për Studime Juridike dhe Politike/Lëvizja Fol), që kanë monitoruar procesin e zhvilluar në KPK.<sup>6</sup> Në atë Raport vihet në pah në mënyrë të qartë se paneli vlerësues, në rastin e kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit, nuk ka adresuar pyetjet adekuate, në përputhje me Udhëzuesin për nenet 13 dhe 14 të Rregullores Nr.06/2019. Në këtë Raport, janë ngritur dyshime të bazuara se koncept - dokumenti i kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit dhe intervista e tij, përmbajnë mangësi

<sup>5</sup> Opinioni i Komisionit të Venecias rreth Projektligjit për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnje dhe Hercegovinës, (2014) p. 41.

<sup>6</sup> “Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit” (2022) Instituti i Kosovës për Drejtësi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Lëvizja Fol.



serioze profesionale, si të natyrës teknike ashtu edhe asaj menaxheriale, që nuk mund të justifikonin poentimin pothuajse maksimal (98 nga gjithsej 100 pikë).

Ndërsa, sa i përket integritetit, siç rezulton nga dokumentacioni i konkursit dhe siç kanë theksuar edhe monitoruesit e pavarur të procedurave të zhvilluara në KPK, pyetjet të cilat janë bërë për vlerësimin e integritetit të kandidatëve kanë qenë pyetje tejet formale, sipërfaqësore dhe të cilat nuk kanë mundësuar vlerësimin e vërtetë të figurës së kandidatëve, apo reputacionit të tyre profesional, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e cekur më sipër. Ndonëse dështimi për të ndërmarrë veprime për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri ligjor vërehet edhe në rastet e disa kandidatëve të tjerë, kjo vihet në dukje sidomos në rastin e kandidatit të propozuar nga KPK-ja, për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Kësisoj, edhe pse Udhëzuesi e përcakton bazën që KPK-ja, të bëjë vlerësim të pavarur të integritetit të kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit, KPK-ja, praktikisht e la në diskrecion të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit që të vendoste se a dëshiron të tregojë nëse kishte raste që vinin në dyshim integritetin e tij. Gjatë intervistimit të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit nuk u adresuan, madje as sipërfaqësisht, lajme e artikuj të shumtë të medieve me të cilat paraprkisht ishin ngritur dyshime mbi integritetin dhe profesionalizimin e tij. Adresimi i pretendimeve të tilla, pavarësisht sa janë të qëndrueshme ato, jo vetëm që është i domosdoshëm për plotësimin e kriterëve ligjore, por gjithashtu do t'i kontribuonte transparencës dhe ngritjes së besimit të qytetarëve në procedurën e zhvilluar në KPK dhe përgjithësisht në sistemin prokurorial.

Ndërlidhur më rëndësinë e paanshmërisë dhe transparencës, si një aspekt kyç për të fituar besimin e qytetarëve, sjellim në vëmendje Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI99/14 dhe KI100/14. Në këtë Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, sqaroi se: *“në mënyrë të veçantë duke iu referuar rëndësisë dhe natyrës së pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykata vëren se edhe shfaqjet [dukjet] e paanshmërisë mund të jenë të një rëndësie të veçantë.”*

Përkitazi me rëndësinë që ka ligjshmëria e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë – si për besimin e qytetarëve ndaj institucionit e poashtu edhe në vlerësimin e duhur të kandidatëve – Komisioni i Venedikut në “Raportin për Standardet Evropiane Lidhur me Pavarësinë e Gjyqësorit: Pjesa II – Sistemi Prokurorial,” të vitit 2010 (më tutje: Raporti i Komisionit të Venedikut i vitit 2010), ka theksuar se: *“është e domosdoshme që si prokuror të emërohen persona të duhur me reputacion të lartë dhe karakter të mirë. Kërkesat për emërimin e prokurorëve janë të njëjta me ato të gjyqtarëve dhe kërkojnë ekzistimin e procedurave të duhura për emërimin dhe promovimin e tyre.”*

Për më tepër, sipas Raportit Nr. 13 (2018) të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë “profesionalizmi, karakteri, guximi, barazia e vendosmëria janë kriterë determinues në procesin e përzgjedhjes së prokurorëve”.<sup>7</sup> I njëjti raport, tek pjesa e

<sup>7</sup> Opinioni Nr. 13 (2018) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE) i Këshillit të Evropës, i titulluar “Pavarësia, Përgjegjshmëria dhe Etika e Prokurorëve”, par. 23.



rekomandimeve, përcakton se “prokurorët duhet të zgjedhen bazuar në respektim të barazisë gjinore, të vlerave etike dhe morale dhe të shkathtësisë të tyre”. Sa i përket ngritjes në detyrë të prokurorëve, po ky raport potencon se ‘ngritja në detyrë e prokurorëve duhet të jetë e bazuar në meritokraci”.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tashmë ka përcaktuar rëndësinë e kriterëve të ligjshmërisë në procesin e përzgjedhjes së organeve të drejtësisë. Për shembull, duke interpretuar nenin 6 të KEDNJ, Gjykata ka vendosur se themelimi i organeve të drejtësisë ‘sipas ligjit’, “reflekton parimin e sundimit të ligjit, i cili është qenësor në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të përcaktuar me Konventë dhe në Protokollin e saj... dhe se një organ që nuk themelohet sipas ligjit do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike, për të dëgjuar ankesat individuale” të qytetarëve<sup>8</sup>. Për më tepër, Gjykata ka vendosur se duke pasur parasysh implikimet fundamentale për funksionimin e duhur dhe me legjitimitet të sistemit gjyqësor në një shtet demokratik ku sundon ligji, ”**procesi i emërimit të gjyqtarëve domosdoshmërisht përbën një element qenësor të konceptit të ‘themelimit të organeve gjyqësore sipas ligjit’.**”<sup>9</sup> Siç është konfirmuar edhe në Opinionin e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, këto standarde vlejné edhe për prokurorinë sepse “statusi, pavarësia, rekrutimi dhe karriera e prokurorëve, duhet qartësisht të jenë të ndërtuara, sikur ato të gjyqtarëve dhe të jenë të udhëhequra nga transparenca dhe kriteret objektive” dhe në anën tjetër “pavarësia e prokurorisë publike është një rrjedhojë e domosdoshme për pavarësinë e gjyqësorit.” Ky Opinion, është cituar edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese e Kosovës në Aktgjykimin e saj nr. KO 100/22 dhe KO 101/22 të vitit 2023.

Duke anashkaluar këto standarde e parime të domosdoshme, KPK-ja, ka dështuar që të sigurojë procedurë të ligjshme të vlerësimit të integritetit dhe profesionalizmit të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror.

## ***2.2. Mohimi i mundësisë për mjet ankimor efektiv brenda KPK-së për kandidatët e pakënaqur dhe mungesa e një vendimi për meritat e çështjes në procedurat gjyqësore***

Një shqetësim tjetër serioz që del nga analiza e procedurës së zhvilluar në KPK është edhe mohimi i mjetit efektiv të ankesës brenda KPK-së. Komisioni i KPK-së për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve ndaj procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit nxori një Raport voluminoz me vërejtje serioze procedurale dhe rekomandime konkrete (shih pikën 2.3 më poshtë). Si rrjedhojë, Komisioni për Rishqyrtim rekomandoi rishqyrtimin e arsytimit dhe vlerësimit për disa prej kandidatëve. Megjithatë, KPK-ja, vendosi që ta shpërfillte tërësisht këtë Raport, pa dhënë arsytim për këtë veprim.

<sup>8</sup> Shih vendimet e GJEDNJ në rastet: *Jorgic kundër Gjermanisë* (2007) par. 64; *Richert kundër Polonisë* (2011) par. 41; *Lavents kundër Latvisë* (2002) par. 114; *Gorgiladze kundër Gjeorgjisë* (2009), par. 67; *Kontalexis kundër Greqisë* (2011) par. 38.

<sup>9</sup> GJEDNJ në rastet *Kontalexis kundër Greqisë* (2011), par. 42; *Godmundur Andri Astradsson kundër Islandës* (2020) par. 227.



Është me rëndësi të theksohet se vetë mundësia që KPK-ja, ta refuzojë Raportin e Komisionit për Rishqyrtim, ku Komisioni gjen shkelje, mohon të drejtën e kandidatëve për mjet efektiv juridik brenda KPK-së. Kjo qasje e KPK-së e shndërron raportin e Komisionit në një “mendim këshillëdhënës”, dhe e delegitim Komisionin për Rishqyrtim nga çdo mundësi për të ndikuar në mbarëvajtjen e procedurave të zhvilluara në KPK. Kjo qasje ndërton dhe një precedent të rrezikshëm për proceset e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit në të ardhmen. Një praktikë e tillë është në kundërshtim edhe me frymën e Kushtetutës, sidomos neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], sikundër edhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>10</sup>

Në ndërlidhje me këtë, është me rëndësi të theksohet fakti që ankesat e kundërkandidatëve lidhur me shkeljet e mundshme ligjore në procedurat e zhvilluara në KPK nuk arritën të shqyrtohen në merita, në asnjë shkallë gjyqësore, të cilat kanë refuzuar paditë dhe ankesat e tyre mbi baza procedurale.

Si rrjedhojë, kandidatët e pakënaqur të cilët kanë ngritur pretendime për shkeljet ligjore në procedurën e zhvilluar në KPK për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, nuk kanë pasur në dispozicion asnjë mjet juridik efektiv për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Ndërlidhur me shkeljet ligjore në procedurën e zhvilluar, sjellim në vëmendjen tuaj Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI99/14 dhe KI100/14, ku Gjykata pikërisht duke vlerësuar procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, mes tjerash, kishte theksuar se: “Gjykata konsideron se KPK-ja gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, është dashur të përmbush parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të siguroj procedurë të zgjedhjes transparente, të drejtë dhe objektive, të bazuar në barazi.”<sup>11</sup>

Këto aktgjykime, përveçse rikonfirmojnë obligimin e KPK-së që t'i respektojë vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç përcaktohet në nenin 53 të Kushtetutës, poashtu kanë vendosur korniza të qarta rreth parimeve që duhet të respektohen nga KPK-ja, në procedurat e përzgjedhjes së Kryeprokurorit, parime të cilat fatkeqësisht janë shkelur nga KPK-ja në rastin konkret. Këto standarde të vendosura edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë standarde, të cilat KPK-ja nuk mund t'i anashkalojë, duke

<sup>10</sup> Sa i përket kësaj çështje, është me rëndësi të vihet në pah praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese dhe e GJEDNJ-së. Sipas interpretimeve të të dyja këtyre gjykatave, nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 13 i KEDNJ-së kërkojnë që sistemi juridik të vë në dispozicion një mjet efektiv juridik që autorizon organin kompetent të adresojë thelbin e një pretendimi për shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih rastin KI 193/18, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (2020) par. 131-132); rasti i GJEDNJ *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, (2018) par. 81.

<sup>11</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pika 73.



zhvilluar procedurë në kundërshtim të plotë me parimet e mjetit juridik efektiv si dhe parimet e barazisë, objektivitetit, drejtësisë e transparencës.

### ***2.3. Shkeljet e evidentuara nga Komisioni për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve të cilat kanë mbetur të paadresuara***

Nga analizimi i dokumenteve të ofruara nga KPK-ja, qartësisht vërehet se Komisioni për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve ndaj procesit të Emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, si komision i brendshëm i KPK-së, ka aprovuar si të bazuara kundërshtimet nga ana e të gjithë kundërkandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit.

Ky Komision ka konstatuar parregullsi sidomos me mënyrën e poentimit të kandidatëve, që është element kryesor i tërë procedurës së zhvilluar në KPK.

Komisioni për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve ka konstatuar se janë gjithsej katër kategori të ndryshme në të cilat vlerësimi nga ana e Panelit Vlerësues të KPK-së nuk është arsyetuar dhe poentuar në përputhje me Udhëzuesin për nenet 13 dhe 14 të Rregullores 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.

Këto kategori janë si në vijim:

- 1. Kategoria e Koncept Dokumentit dhe Prezantimi i tij;*
- 2. Kategoria Shkathtësitë Udhëheqëse dhe Menaxheriale;*
- 3. Kategoria e Njohurive Teknike dhe Përvojës;*
- 4. Kategoria e Integritetit të Kandidatit.*

Kundërkandidatët kanë ngritur një mori shkeljesh, prej të cilave 26 pretendime konkrete për shkelje, të cilat janë pranuar plotësisht apo pjesërisht nga Komisioni për Rishqyrtim.

Këto gjetje të Komisionit në fjalë janë konstatuar edhe nga organizata të pavarura që janë marrë me monitorimin e procedurave të zhvilluara në KPK. Kështu, nga një raport lidhur me gjetjet e monitorimit të procesit të zhvilluar për Kryeprokuror të Shtetit, që Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN ka paraqitur më 20 prill 2022 në ZPRK, janë identifikuar dhe konfirmuar gjetjet e Komisionit për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve.<sup>12</sup> Në Raportin e BIRN, evidentohen defekte serioze në poentim, sepse anëtarët e Panelit Vlerësues kanë dështuar të arsyetojnë pikët e tyre në vlerësim.

---

<sup>12</sup> Raporti i BIRN drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës lidhur me gjetjet e monitorimit të procesit për Kryeprokuror të Shtetit (prill 2022).



Tek poentimi, është e rëndësisë së veçantë të vihet në dukje interpretimi i Gjykatës Kushtetuese e cila poentimin, përkatësisht ndryshimet e pabazuara në standardet e poentimit, i lidhë ngusht më parimin e sigurisë juridike. Në këtë drejtim, në Aktgjykimin KI99/14 dhe KI100/14, Gjykata Kushtetuese duke vlerësuar poentimin në rastin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit, theksoi se: "Gjykata rikujton se ky parim është i mishëruar në mënyrë të qartë me një nga të drejtat themelore të mbuluara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parimi i sigurisë juridike është në rrezik në qoftë se detyrimet ligjore nuk respektohen plotësisht. Gjykata rikujton se ky parim gjithashtu duhet të garantohet gjatë procesit të zgjedhjes të zhvilluar nga të gjitha autoritetet publike. Prandaj, KPK-ja, gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të emërimit, ishte e nevojshme të mbante të njëjtat standarde për secilin kandidat."<sup>13</sup>

Përkundër gjithë këtyre gjetjeve, mënyra se si KPK-ja, i është qasur Raportit të Komisionit për Rishqyrtim, duke e shpërfillur atë tërësisht, anashkalon rolin e Komisionit për Rishqyrtim brenda KPK-së. Kjo minon çfarëdo garancie të transparencës publike, vlerësimin objektiv dhe meritore dhe për pasojë, hedhë hije të forta dyshimi për ligjshmërinë e procedurave të zhvilluara në KPK për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Për më tepër, Këshilli Prokurorial, ka dështuar ta implementojë edhe një standard që ka të bëjë me respektimin e rregullave të veta. Ky fakt është cekur edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin KI99/14 dhe KI100/14. Gjykata teksa ka vlerësuar rëndësinë e dokumenteve të nxjerra nga KPK-ja lidhur më vlerësimin, ka konstatuar mes tjerash që: "KPK-ja, duke injoruar rregullat e veta të përcaktuara, krijon një situatë të karakterizuar me supozim të arbitraritetit."<sup>14</sup>

Duke mos respektuar rregullat e veta, KPK-ja ka dështuar t'u ofroj palëve arsyetimin e nevojshëm lidhur më refuzimin e gjetjeve apo konstatimeve që ka bërë Komisioni për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve. Sipas Gjykatës Kushtetuese: "E drejta për një vendim të arsyetuar i ka rrënjët në një parim më të përgjithshëm të mishëruar në KEDNJ, që mbron një individ nga arbitrariteti. Në këtë drejtim: "Vendimi duhet të përmbajë arsyet që janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur aspekteve thelbësore të argumentit faktik dhe juridik material ose procedural të palës."<sup>15</sup>

Pikërisht, duke vlerësuar rrethanat e mungesës së një arsyetimi adekuat, që vjen si rezultat i mos zbatimit të rregullave të brendshme të KPK-së, në rastin paraprak Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se: "dështimi i KPK-së në Vendimin e tij, KPK nr.: 146/2014, të 5 qershorit 2014, që të pranojë rregullat e veta të përcaktuara dhe që të sigurojë një arsyetim të qartë në lidhje me aspektet thelbësore të argumentit faktik dhe ligjor procedural, është në kundërshtim me të drejtën për një procedurë të drejtë. Në këtë mënyrë,

<sup>13</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pika 84.

<sup>14</sup> Po aty, pika 85.

<sup>15</sup> Shih, mutatis mutandis, *Ruiz Torija kundër Spanjës* ECHR (1994) par. 30. Shih poashtu Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pika 86.



Gjykata konsideron se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me nenin 24 të Kushtetutës”.<sup>16</sup>

Pikërisht për të tilla shkelje, rikujtojmë se Gjykata Kushtetuese, kishte ardhur në përfundim se e tërë procedura e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të përsëritet, pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure të përsëritur.<sup>17</sup>

#### *2.4. Mungesa e transparencës si dhe cenimi i parimeve të barazisë dhe meritokracisë*

Në dritën e asaj që u tha më sipër, nga vlerësimi që Presidenca i ka bërë dokumentacionit dhe raporteve lidhur me procedurat e zhvilluara në KPK, është e dukshme se ky proces nuk ka garantuar transparencë, si dhe trajtim të barabartë dhe meritore të kandidatëve.

Në këtë drejtim, sjellim në vëmendjen tuaj se në raportin e publikuar në mars 2022 nga koalicioni i OJQ-ve monitoruese, të titulluar: “Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit”, janë theksuar gjetjet si: mosrespektim i Udhëzuesit i cili përcakton parimet dhe procedurën që Paneli Vlerësues do të ndiqte për të siguruar një proces objektiv dhe transparent; koncept dokumenti kishte pyetje të bazuara në ligjet e shfuqizuara dhe të ndërlidhura me proceset të cilat janë në kompetencë të KPK-së dhe jo të Kryeprokurorit të Shtetit; dyshime për rast të konfliktit të interesit; trajtim të pabarabartë të kandidatëve gjatë procesit etj.

Konsiderojmë se gjetjet dhe sugjerimet e Raportit të Koalicionit të OJQ-ve monitoruese lidhur me procedurën e zhvilluar në KPK, nuk mund të shpërfillen tërësisht, aq më tepër kur këto konstatime janë të bazuara edhe në vetë raportin e Komisionit për Rishqyrtimin e Kundërshtimeve. Si të tilla, këto vërejtje janë identifikuar edhe në vlerësimin që Presidenca i ka bërë procedurës së zhvilluar në KPK.

Lidhur më rëndësinë e një procesi transparent, Komisioni i Venedikut, në opinionin 712 / 2013, të seancës së 89-të Plenare 21-22 Mars 2014, në pikën 71, duke trajtuar ligjin për emërimet e larta në gjyqësor dhe prokurori, thekson se këshilli i lartë gjyqësor dhe prokurorial: “duhet të jetë maksimalisht transparent, dhe llogaridhënës para publikut dhe qytetarëve, dukë ofruar raporte dhe informata të hollësishme.”<sup>18</sup> Mungesa e transparencës është konstatuar edhe në deklaratat publike të përfaqësive diplomatike në Kosovë, të cilat kanë monitoruar këtë proces.

Për më tepër, neni 24 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se: “të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim dhe se: “askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë,

<sup>16</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pikat 92 dhe 93.

<sup>17</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), pika 94.

<sup>18</sup> Opinion rreth Projektligjit për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnje dhe Hercegovinës, Komisioni i Venecias, (2014), pika 71.



mendimeve politike ose të tjera...”. Më specifikisht, neni 7(2) i Kushtetutës parasheh se: “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore”. Në lidhje me këtë, neni kushtetues që i referohet Prokurorit të Shtetit (neni 109, par. 4) përcakton se: “Prokurori i shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore”, ndërkaq neni që i referohet propozimeve që vijnë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (neni 110, par. 3) përcakton se këto propozime duhet të pasqyrojnë, ndër të tjera edhe “parimin e barazisë gjinore”. Fatkeqësisht, e tërë procedura e përzgjedhjes së Kryeprokurorit nuk e ka përfshirë asnjë kandidatë grua, duke dështuar kështu që ta garantojë parimin e barazisë gjinore, të përcaktuar me Kushtetutë, edhe pse gjykata kushtetuese kishte vendosur në vitin 2014, se ky parim “duhet të garantohej përgjatë tërë procedurës së zgjedhjes në institucionet e Republikës së Kosovës.”<sup>19</sup>

## ***2.5. Vërejtjet e adresuara nga Raporti i Bashkimit Evropian për Kosovën për vitin 2022 dhe nga përfaqësitë diplomatike në Kosovë***

Ndërlidhur me gjetjet e cekura më sipër, sjellim në vëmendje edhe konstatimet e Raportit për vendin të Bashkimit Evropian, përkitazi me procedurat e zhvilluara në KPK. Në Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), Raporti trajton në veçanti procedurën e përzgjedhjes së Kryeprokurorit.<sup>20</sup> Në këtë Raport theksohet zhgënjimi për mungesën e drejtësisë, transparencës, dhe parimeve të meritës në procedurën e përzgjedhjes së Kryeprokurorit nga ana e KPK-së. Këto dështime, Raporti i BE-së për Kosovën i thekson si gjetje të konstatuara nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjermanisë.

Më konkretisht, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka theksuar, ndër të tjera, se: “fakti se anëtarët e KPK-së, kanë shpërfillur ankesat e ligjshme dhe rekomandimet e Panelit për Rishqyrtim”, përgjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror, tregon se procesi nuk i ka përmbushur standardet e “të qenit proces i drejtë, objektiv, transparent dhe i bazuar në merita”. Zyra e BE-së në Kosovë, nga ana tjetër, ka potencuar se: “përkundër thirrjeve të vazhdueshme të BE-së për sigurimin e një procesi të përzgjedhjes që është i drejtë, transparent dhe i bazuar në merita, KPK-ja ka përmbyllur këtë proces duke i shpërfillur këto parime”. Ky vlerësim është bërë edhe nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë, duke potencuar se një procedurë e tillë është zhgënjyese dhe nuk është mënyra e duhur për të ecur përpara, sidomos “duke pasur parasysh që OJQ-të e Kosovës, si IKD dhe GLPS kanë shprehur shqetësime të ngjashme”.

<sup>19</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14 (2014), par. 89.

<sup>20</sup> Raporti për Kosovën i vitit 2022 i Komisionit Evropian, f. 20.



Këto vlerësime, duke pasur parasysh peshën e tyre, janë konfirmim shqetësues i të gjitha defekteve dhe devijimeve që e kanë përcjellë procesin e përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Kjo duke pasur parasysh faktin që raportet e tilla janë parametër i rëndësishëm i vlerësimit ndërkombëtar lidhur me reformat në drejtësi dhe përgjithësisht në procesin e integritetit të Republikës së Kosovës në strukturat euroatlantike.

Secili institucion i vendit, duke përfshirë edhe KPK-në, duhet të reflektojë me kujdes ndaj këtyre gjetjeve të Raportit të vendit të BE-së për Kosovën si dhe konstatimeve të përfaqësive të tjera diplomatike në Kosovë. Si bartës institucionesh, është obligim i yni që të kontribuojmë në avancimin e integritetit euroatlantik të shtetit tonë, në veçanti duke kontribuar për një sistem të drejtësisë të pavarur, profesional, transparent e me integritet.

## *2.6. Mungesat e evidentuara ne dokumentacionin e ofruar nga KPK-ja*

Përveç gjetjeve të trajtuara më sipër që kanë të bëjnë me shkeljet në procedurat e zhvilluara në KPK, është e rëndësishme të vëmë në pah se dokumentacioni që KPK-ja, ka dorëzuar në Presidencë, lidhur me procedurën e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, ka qenë i mangët. Ky dokumentacion, përkatësisht dosja e këtij procesi, është paraqitur në Presidencë fillimisht si dosje e propozimit, e pastaj, më kërkesën e Presidencës për dokumentacion shtesë, janë dërguar edhe dokumente të tjera. Më saktësisht, kemi vërejtur se në dokumentacionin e pranuar mungon fletë-poentimi i vlerësimit të kandidatit të propozuar për Kryeprokuror të Shtetit. Për dallim nga dosja e 4 kundërkandidateve ku gjinden edhe vlerësimet edhe arsyetimet, tek dosja e kandidatit të propozuar mungon pjesa e fletë-poentimit dhe arsyetimit të poentimit. Po ashtu, nga analizimi i dokumentacionit kemi vënë re se dosja që KPK-ja, ia ka vënë në dispozicion Presidencës nuk përfshinë disa dokumente që në të kaluarën ishin përfshirë në dosjen e propozimit për kryeprokuror. Kështu, për dallim nga praktikat e kaluara të dorëzimit të dokumenteve përcjellëse të propozimit për Kryeprokuror, tek dokumentacioni që KPK-ja ia ka vënë në dispozicion Presidencës, nuk janë përfshirë dokumentet, si: Dokumentet e pranuar nga zyra e Prokurorit Disiplinor, Dokumentet e pranuar nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, Dokumentet e pranuar nga Agjencia Kundër Korrupsion, Dokumentet e pranuar nga Njësia e Inteligjencës Financiare, etj. Këto informata e dokumente nuk janë dorëzuar nga ana e KPK-së përkundër faktit që KPK-ja, ka pasur mundësi ta plotësojë dosjen e propozimit bazuar në kërkesën e Presidencës për dokumente plotësuese.



## Përfundim

Presidentja e Republikës së Kosovës, e ngarkuar me përgjegjësinë për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese, nuk mund të qëndrojë shpërfillëse ndaj fakteve që komprometojnë procedurën e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit – njërës prej pozitive kyçe në sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës. Do të ishte në kundërshtim me aspiratën tonë shtetërore për forcimin e sundimit të ligjit dhe të një sistemi të drejtësisë që ushqen besimin e qytetarëve, nëse Presidentja e vendit për ligjë procedurën e zhvilluar në KPK për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, pavarësisht konstatimeve për shkelje të theksuara procedurale. Këto konstatime janë bërë nga vet organet e brendshme të KPK-së, monitoruesit e pavarur vendorë dhe ndërkombëtarë; raporti i BE-së dhe raporte të tjera dhe si të tilla, janë identifikuar edhe nga Presidenca. Për më tepër kur këto pretendime për parregullsi kanë mbetur pa u adresuar në mënyrë meritore nga ndonjë instancë gjyqësore.

Pavarësia, integriteti dhe besimi i qytetarëve në sistemin prokurorial janë jetike për sistemin e drejtësisë. Një emërim në një organ kushtetues nuk mund të jetë në përputhje me Kushtetutën nëse ekzistojnë fakte dhe konstatime, madje edhe nga trupa të brendshëm të KPK-së, se ai është rezultat i një procedure me shkelje dhe diskriminim. Një emërim i tillë minon besimin që qytetarët duhet të kenë në sistemin e drejtësisë e sidomos në sistemin prokurorial si hallka qenësore e këtij sistemi.

Rrjedhimisht, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë kushtetuese të Presidentes së Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga KPK-ja dhe analizimit të raporteve të monitoruesve të pavarur, vendor e ndërkombëtar, vlerësohet se procedura e ndjekur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, rezulton të mos i ketë plotësuar kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Si pasojë e këtyre shkeljeve, procedura e zhvilluar në KPK nuk ka garantuar plotësimin e kriterëve të integritetit dhe profesionalizimit si dhe zbatimin e parimeve të transparencës, barazisë dhe meritokracisë.